



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. Prot. Prot. No.	6632-2/25
Nr. i fazeve Broj, stranica No. pages	03	Data Datum Date	21.09.26
PRISHTINE/IA			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	16.09.2026
REFERENC-Ë:	25/6632/MMPH
PËR/ZA/TO:	"HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, Stacion i karburanteve në Preoc, Graçanicë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për aprovim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve me Nr. Prot. 25/6632/MMPH.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve Ferizaj, për veprimtarinë: Stacion i karburanteve në Preoc, Graçanicë; dhe
- Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/6632/MMPH
Datë: 16.09.2026


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 1, 5 dhe 7 dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore si dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.14/5440/1-ZSP/ 18/15, datë: 28.01.2015, dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore te dt. 24.08.2026, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Operatorit "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve, pajiset me Leje Mjedisore për stacionin e karburanteve, ne ngastren kadastrale me nr. P- 73414058-00697-1 Preoc-Graçanicë me kapacitet të rezervuarve për naftë dhe benzinë $V_1 = 29891$ litra, $V_2 = 31792$ litra, $V_3 = 29643$ litra, $V_4 = 30072$ litra, $V_5 = 49165$ litra, $V_5 = 48657$ litra, si dhe rezervuarin e GLN-së $V_7 = 15000$ litra.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Të kontrollohet dhe mirëmbahet seperatori i vajrave dhe lubrifikantëve;
- 2.3. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;



2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;

2.5. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të bejë rehabilitimin e zonës se ndikuar.

Ar sy e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe debatit publik për operatorin "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve, është konstatuar se Operatori për stacionin e karburanteve, ne ngastren kadastrale me nr. P- 73414058-00697-1 Preoc-Graçanicë me kapacitet të rezervuarve për naftë dhe benzinë $V_1= 29891$ litra, $V_2= 31792$ litra, $V_3= 29643$ litra, $V_4= 30072$ litra, $V_5= 49165$ litra, $V_5= 48657$ litra, si dhe rezervuarin e GLN-së $V_7= 15000$ litra, plotëson kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr.04/2022 për Leje Mjedisore dhe Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

UD Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së